VENDIM
Nr. 60, datë 6.2.2023

PËR DËRGIM PERSONELI ME MISION HUMANITAR NË TURQI, NË MBËSHTETJE TË AUTORITETEVE TURKE PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR NGA TËRMETI I DATËS 6 SHKURT 2023

(ndryshuar me VKM nr. 73, datë 8.2.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e personelit, të përbërë nga *73 (shtatëdhjetë e tre)* veta, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes me mision humanitar, në Turqi.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është mbështetja e autoriteteve turke, që menaxhojnë dhe drejtojnë operacionet e përballimit të situatës së krijuar nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023, zhvillimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit në ambiente urbane (USAR), si dhe dhënia e ndihmës mjekësore të menjëhershme.

3. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është në Gaziantep *dhe Adana*, Turqi.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni humanitar është *me sistem rotacioni*. Periudha e qëndrimit fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit në mision.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit në mision, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) akomodim;

c) ushqim;

ç) ujë të pijshëm;

d) energji elektrike;

dh) lavanderi;

e) sigurim jete;

ë) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

f) mbështetje shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) transport;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

6. Transporti i personelit, që merr pjesë në misionin në Turqi, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama